

Jo valid (Foto 4)

Nuk ekziston vijë kontrolluese ose vetëm vijë e testimi. Përsëriteni analizën me një TEST PL-LAKË, duke i ndjekur me kujdes udhëzimet. Analizat laboratorike i bën laboranti dhe menjëherë e njofton pacientin për rezultatet (raport me shkrim). Me këtë rezultat pacienti duhet të drejtohet te mjeku amë. Rezultatet e marra (pozitive ose negative) plotësohen edhe në pyetësonin në Qendrën e shëndetit publik për secilin pacient në veçanti. Pas plotësimit të pyetësonit deri te pyetja e 16, pyetësoni dorëzohet te specialisti i mjekësisë sociale në Qendrën e shëndetit publik.

DETYRIMET E SPECIALISTIT TË MJEKËSISË SOCIALE DHE PUNONJËSIT TË STATISTIKËS SHËNDETËSORE PRANË QENDRËS SË SHËNDETIT PUBLIK

Specialisti koordinon punën në nivel të Qendrës; Specialisti organizon dhe kryen trajnimin e mjekëve amë në kujdesin shëndetësor primar dhe u jep broshura dhe udhëzime; Punonjësi i statistikës shëndetësore i ruan të dhënat me ndihmën e një softueri special dhe mirëmban evidencën; Specialisti kontakton me mjekët amë për kompletimin e plotë të të dhënave që kërkohen në pyetësonin, dhe atë pyetjet nën numër 17 dhe 18;

Specialisti ka për detyrë të dërgojë te Instituti i shëndetit publik- Sektori për promovim, analizë dhe monitorim të sëmundjeve jo të transmetueshme, raporte periodike tremujore të numrit të pacientëve të ekzaminuar.

Specialisti pas përfundimit të testeve të planifikuara, bazën e të dhënave në një CD e dërgon tek Instituti i shëndetit publik.

DETYRIMET E INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK - SEKTORI PËR PROMOVIM, ANALIZË DHE MONITORIM TË SËMUNDJEVE JO TË TRANSMETUESHME

Përgatitja e posterit;
Përgatitja e udhëzimeve për punë;
Përpilimi i pyetësonit;
Përgatitja e broshurave;
Përgatitja e softuerit - Regjistri i KKR;
Koordinimi i aktiviteteve me qendrat dhe Ministria e shëndetësisë;
Shpërndarja e udhëzimeve, pyetësonëve dhe broshurave deri te Qendrat e shëndetit publik;
Përgatitja e raporteve bazuar në raportet e marra nga qendrat dhe dorëzimi i tyre tek Ministria e shëndetësisë;
Përpunimi i të dhënave dhe përgatitja e raporteve për rezultatet e skringut.



Ministria e shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë



Instituti i shëndetit publik i Republikës së Maqedonisë

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E SKRININGUT TË KARCINOMIT KOLOREKTAL



DETYRIMET E MJEKUT AMË

Mjeku amë vendos se cili pacient do i nënshtrohet testit FOB për detektimin e hershëm të kancerit të zorrës së trashë. Përparësi kanë personat të cilët shikuar sipas anamnezës japin shenja të pranisë së faktorëve të rrezikut (person të sëmurë nga kanceri i zorrës së trashë në mesin e familjarëve të tyre, probleme me jashtëqitjen, ose probleme të tjera).

Mjeku amë i ndërmerret këto veprime:

- Jep udhëzimin për realizimin e testit FOB;
- Sqaron mënyrën dhe dinamikën e marrjes së mostrave nga fekalet (tre jashtëqitje të njëpasnjëshme) në një afat kohor prej 7 ditëve;
- Jep 3 epruveta – flakone;
- Udhëzon në Qendrën e Shëndetit Publik- në njësinë e pranimit ku, detyrimisht brenda një jave nga marrja e mostrave bëhen analizat;
- Informon pacientin për detyrimin e tij për të lajmëruar mjekun amë për rezultatet e testimit;
- Në rast të rezultateve pozitive mjeku amë e udhëzon pacientin për analiza të mëtejme;
- Pacientët nuk i nënshtrohen testimit nëse në ndërkohë trajtohen me terapi antikoagulante, nëse kanë gjakderdhje ose nëse gjatë 7 ditëve të fundit kanë pasur ndonjë ndërhyrje në zgavrën e gojës ose rektum!

DETYRIMET E LABORANTËVE NË QENDRËN E SHËNDETIT PUBLIK

Në njësinë e pranimit laboranti:


- Merr epruvetat nga pacienti;
- Në një fletore i regjistron të dhënat e tij (emrin, mbiemrin dhe numrin e telefonit);
- Materialin e marrë ai e përcjell në laborator për tu analizuar;
- Pacientit detyrimisht i dorëzon një pyetësor të cilin nëse është në gjendje ai e plotëson menjëherë, në të kundërtën e plotëson laboranti;
- E merr pyetësorin dhe e ruan në dosje të Qendrës së shëndetit publik.

REALIZIMI I ANALIZAVE DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Hexagon OBTI

1. Shkudeni mirë EPRUVETËN me qëllim që të përzihet mirë i gjithë materiali.
2. Vendoseni EPRUVETËN në një sipërfaqe të rrafshët.
3. Mbulojeni kapakun e kuq me një letër për të mos lejuar derdhjen e tretjes. Mbajeni epruvetën me kapakun e kuq kah lartë dhe thyeni majën.

4. Pikoni tre pika në një TEST PLLAKË
5. Pritni rreth 5 minuta në një vend të ndriçuar mirë për të lexuar rezultatin. Rezultatet negative do duhej të vërtetohen pas 10 minutash.



Negativ (Foto 1)

Vija e kuqe e kontrollit (C) shfaqet në pjesën e sipërme të dritares katërkëndëshe që tregon rezultatin, që tregon se testimi është në rregull dhe që reagensët kanë funksionuar.

Pozitiv (Foto 2 dhe 3)

Vija e kuqe e dytë e Test pllakës (T) e cila shfaqet në pjesën e poshtme të dritares katërkëndëshe që tregon rezultatin, tregon për një rezultat pozitiv për prezencën e hemoglobinës në mostrën e marrë. Madje edhe një vijë e zbehtë është tregues për një rezultat pozitiv (Foto 3).

Mes vijës së testimit dhe vijës kontrolluese mund të shfaqet një intensitet i ndryshëm i ngjyrës, por kjo gjë nuk ndikon në interpretimin e rezultateve.